

I. Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit, Departamenti i Bazave të Informatikës shpall 1 (një) vend pune për personel akademik me kohë të plotë, në kategorinë asistent-lektor ose lektor në fushat e mëposhtme:

- Informatikë (inxhinieri ose shkenca kompjuterike);
- Teknologji informacioni;
- Elektronikë-telekomunikacion

që të mbulojë lëndët e bazave të Informatikës në programet e studimit të ciklit të parë, Bachelor, në të gjitha njësitë kryesore të UPT që i kanë të përfshira ato lëndë në programet e tyre të studimit.

Kandidatët për këtë vend pune, duhet të dorëzojnë dokumentacionin (origjinal ose kopje të noterizuara), në plotësimin e kërkesave, si më poshtë:

a) Dokumente dhe kritere kualifikuese renditëse:

a.1. Të kenë mbaruar studimet në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit ose Universitete të huaja, në sistemin 5 (pesë) vjeçar ose në sistemin e studimeve 3+2 (Bachelor + Master Shkencor) në fushat e mësipërme;

a.2. Nota mesatare e studimeve universitare (për studimet 5-vjeçare), të studimeve (Bachelor dhe Master i Shkencave) të jetë ≥ 8.5 (e barabartë ose më e lartë se 8.5);

a.3. Dëshminë/Certifikatën e mbrojtjes së gjuhës së huaj, e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare. Preferohet gjuha angleze;

a.4. Dy rekomandime, me datë jo më të hershme se data e daljes së njoftimit përkatës të punësimit, dhe specifikisht të cilësuar për punësim si pedagog i brendshëm në DBI, FTI, nga staf akademik i UPT, nga departamenti përkatës, ose nga departamenti përkatës (i Fakultetit/Universitetit përkatës) ku kandidati ka kryer studimet, me titull "Profesor" ose "Profesor i Asociuar".

b) Dokumente dhe kritere renditëse:

b.1. Artikuj të botuar në Revista Shkencore me Bord Editorial dhe kod ISSN si dhe Referime Shkencore të paraqitura në Konferenca Shkencore dhe të botuara në Proceedings, me kod ISBN. Artikujt dhe referimet shkencore do të vlerësohen si të tilla vetëm në rast të lidhjes së tyre me fushat e mësipërme;

b.2. Trajnime të ndryshme në ato fusha me dëshmi;

b.3. Përvojë në mësimdhënie, të dëshmuar me referenca.

II. Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Departamenti i Gjeodezisë, kërkon të punësojë 1 (një) personel akademik me kohë të plotë të kategorisë asistent lektor për lëndët "Topografi" ose

“Gjeodezi Inxhinierike” në degët Ndërtim, Hodroteknikë, Inxhinieri Mjedisi si dhe në FAU.

Kandidati duhet të plotësojë këto kritere:

1. Të jetë diplomuar në degën Gjeodezi, të ketë të paktën Diplomë Master Shkencor.
2. Nota mesatare si kriter vlerësues:
 - Nota mesatare në nivel BACHELOR të jetë mbi 8.0.
 - Nota mesatare në nivelin Master Shkencor të jetë mbi 8.0.
 - Për kandidatët e sistemit 5-vjeçar, nota mesatare të jetë mbi 8.0.
3. Të ketë mbrojtur me dëshmi gjuhën angleze.
4. Të demostrojë nëse është e mundur me dokumenta eksperiencën me teknologjitë moderne dhe programet profesionale të fushës.
5. Nëse ka të demostrojë edhe eksperiencën në mësimdhënie.
6. Kandidatët që kanë mbaruar MSc jashtë shtetit ose janë në proces doktoreture kanë prioritet në përzgjedhje.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **06.03.2020** pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në Rektoratit e Universitetit Politeknik të Tiranës dokumentacionin e sipërcituar.